

FORUMI "ENERGY TRANSITION DIALOGUE"

Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë Belinda Balluku mori pjesë në forumin e nivelit të lartë "Energy Transition Dialogue" të zhvilluar në Berlin, me pjesëmarrjen e ministrave dhe përfaqësuesve të industrisë së energjikut nga 90 vende të botës. Qëndrueshmëria e burimeve të rinovueshme si dhe siguria energjetike ishin në fokus të diskutimeve të mbajtura në forumin e këtij viti.

ZGJEROHET NËNSTACIONI I HEC KOMAN

Ka përfunduar projekti i zgjerimit të nënstacionit të HEC Koman, një projekt i financuar nga Qeveria Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW. Investimi i kryer është në funksion të ndërtimit të një sistemi modern të transmetimit të energjisë elektrike që do të bënte të mundur rritjen e efikasitetit në menaxhimin e kësaj energjie dhe uljen e humbjeve. Projekti i radhës në kuadër të ndërtimit të këtij sistemi është linja 400 kV Elbasan - Bitola (Maqedoni e Veriut), e cila ka nisur tashmë procedurat për ndërtim.

LINJË E RE E TENSIONIT TË MESËM

Me një investim 468 milionë lekë është bërë i mundur ndërtimi i linjës së re të tensionit të mesëm në të dy krahët e autostradës Laç-Mamurras. Me investimin e ri, janë 4 fidra kabllorë me gjatësi 33 km rrjet kabllor në tension të mesëm, si dhe është shtrirë rreth 25 km rrjet i tensionit të ulët. Gjithashtu janë ndërtuar 30 kabina të reja ku janë sistemuar rreth 500 abonentë me perspektivë zgjerimi në 1500. Ndërtimi i linjës së re ul humbjet në rrjet dhe rrit cilësinë e ofrimit të shërbimit kryesisht për bizneset e mëdha, që janë përqendruar në këtë zonë, duke ndikuar në rritjen ekonomike të qarkut.

SIGURIA NË AEROPORTIN E RINASIT

Ministrja Balluku ka reaguar lidhur me situatën e sigurisë në Aeroportin e Rinasit. Gjatë një konference për shtyp ministrja deklaroi: "Masat e marra nga koncesionari i TIA kanë qenë për të kaluar radhën e për të vazhduar qetësisht vjeljen e kësaj kontrate të gabuar që në gjenezë të saj, kontratë kjo që nuk i ka lënë hapësirë shtetit shqiptar për të penalizuar kompaninë kineze dhe për t'a bërë atë përfundimisht të ndërgjegjshme për dëmin që i ka krijuar Shqipërisë në të gjitha aspektet: financiar, sigurinë kombëtare dhe padyshim dëmtimin e imazhit".

PAKTI PËR UNIVERSITETIN

30 studentë të ekselencës kanë përzgjedhur Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për t'u bërë pjesë e administratës publike. Të rinjtë aplikuan në portalin punëtëmbarë.al, të çelur nga Departamenti i Administratës Publike, ndërsa më pas zgjodhën MIE-në dhe institucionet e saj të varësisë për t'u punësuar. Rekrutimi i ekselentëve në administratën publike është në kuadër të Paktit për Universitetin, të lançuar nga kryeministri si pjesë e marrëveshjes mes qeverisë dhe studentëve.

RINOVIMI I KOMODITETIT TASHMË ONLINE

Duke nisur nga data 15 prill, rinovimi i Lejes së Komoditetit, detyrim për të gjithë zotëruesit e mjeteve të licensuara për transport udhëtarësh e taksi, do të bëhet me vetëdeklarim online. Nga kjo procedurë e re e thjeshtuar, e DPSHTRR-së përfitojnë 9725 mjete. Ndryshimi i vlerësimit të kushteve të komoditetit bën të mundur rinovimin pa e sjellë më mjetin, verifikimi bëhet përmes sistemit dhe jo më përmes letrave, duke kursyer kështu kohë